

ALBANA VOKSHI



Datëlindja: 24.02.1971

Vendlindja: Tiranë

Email: Albana.Vokshi@parlament.al

Jetëshkrimi:

Ka përfunduar studimet universitare në degën Tekstil, në Fakultetin e Inxhinierisë, Universiteti i Tiranës. Ka kryer studimet e nivelit master në Administrim Publik për Politika Ekonomike, në Columbia University, New York, Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Znj. Vokshi nga diplomimi deri në zgjedhjen e saj për herë të parë si deputete, ka ushtruar detyra të ndryshme. Fillimisht ajo ka punuar si specialiste në Këshillin e Ministrave (1995-1999). Nga vitet 1999-2005 ajo ka punuar në funksione të ndryshme pranë organizatave ndërkombëtare si specialiste projektesh në UNDP, në Prishtinë, analiste buxheti pranë USAID, Prishtinë dhe në Kabul, Afganistan.

Në vitet 2005-2009, znj. Vokshi ka mbajtur detyrën e drejtores në Departamentin për Strategji dhe Koordinimin e Ndhmës së Huaj në Këshillin e Ministrave.

Prej vitit 2009, znj. Vokshi është deputete e Partisë Demokratike në Qarkun e Tiranës. Nga viti 2009-2013 ajo ka mbajtur detyra të rëndësishme parlamentare si Kryetare e Nënkomisionit për Barazinë Gjinore dhe Parandalimin e Dhunës ndaj Gruas si dhe ka qenë anëtare e Komisionit parlamentar për Ekonominë dhe Financat dhe Komisionit parlamentar për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë. Nga viti 2013-2017, ajo ka qenë deputete e Partisë Demokratike në Qarkun e Tiranës si dhe ka mbajtur detyrën e Kryetares së Komisionit parlamentar për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë. Në vitet 2017-2019, znj. Vokshi ka ushtruar detyrën e Kryetares së Komisionit parlamentar për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik. Gjatë kësaj periudhe ajo ka qenë Kryetare e Grupit Kombëtar, Parliamentarians for Global Action (PGA).

Znj. Vokshi nga viti 2005 është anëtare e Këshillit Kombëtar të Partisë Demokratike dhe prej vitit 2009 është Kryetare e Lidhjes Demokratike e Gruas së Shqipërisë, PD.